



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1502, datë 10.02.2011

Për

“Fillimin e procedimit administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a dhe Altelecom sh.a”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 10.02.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve AMC sh.a dhe Altelecom sh.a

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, pika 1 e nenit 50, neni 60 dhe neni 120 e vijues të Ligjit nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore nr. 19 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;

5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme” të AKEP (***Rregullorja e Brendshme***), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918,

K Ë SH I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e AMC sh.a nr. 4460/6, datë 18.01.2011 ***“Ankim administrativ mbi aplikimin e tarifave për shërbimet e interkoneksionit në zbatim të VKD nr. 1348 datë 26.07.2010” duke bashkëngjitur korespondenca shkresore midis paleve si më poshte vijon:***
 - Shkresa nr.4002/1 prot, datë 27.08.2010 e Albtelecom sh.a drejtuar AMC sh.a *“Mbi aplikimin e tarifave të interkoneksionit ne zbatim te Vendmit nr. 1348 date 26.07.2010 për përcaktimin e Albtelecom sh.a FNT dhe vendosjen e masave rregulluese”;*
 - Shkresa nr.4460/1 prot, datë 22.10.2010 e AMC sh.a drejtuar Albtelecom sh.a *“Mbi aplikimin e tarifave për shërbimet e interkoneksionit ne zbatim të VKD nr. 1348, date 26.07.2010”;*
 - Shkresë nr.4002/7, datë 04.11.2010 e Albtelecom sh.a drejtuar AMC sh.a *“Në përgjigje Tuajës nr. 4460/1 prt, datë 22.10.2010”, bashkelidhur tabela “Tarifat terminale ne rrjetin e operatoreve Alternative”;*
 - Shkresë nr.4460/5 prot, datë 15.12.2010 e AMC sh.a drejtuar Albtelecom sh.a *“Në përgjigje të letres Tuaj nr. 4002/7 date 05.11.2010”;*
2. Relacion shpjegues mbi projektvendimin (***Relacioni***);
3. si dhe diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AMC sh.a me shkresëm nr.4460/6 prot, datë 18.01.2011 (AKEP: nr. 74 prot, date 19.01.2011), i drejtohet AKEP dhe për dijeni Albtelecom sh.a me ***“Ankim administrativ mbi aplikimin e tarifave për shërbimet e interkoneksionit në zbatim të VKD nr. 1348 datë 26.07.2010”***, sqaron se:
 - AKEP në zbatim të Vendimit nr. 1348 date 26.07.2010 i AKEP *“Për përcaktimin e sipërmarrësit Abtelecom sh.a me Fuqi të Ndjeshem në Treg dhe Vendosjen e masave Rregulluese në Tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonise fikse”, në germen ii) në pikën 4.5.2 të tij përcakton se: “Tarifat maksimale të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetin Albtelecom, sipas vlerave të tabelës së mëposhtme”:*

Aktuale-31.08.2010			1.09.2010-Sipas percaktimeve te Vendimit te AKEP ne piken 4.5.3.	
	Lek/minute	Lek/Thirrje	Lek/minute	Lek/Thirrje
Terminimi i thirrjeve me origjine kombetare ne Albtelecom:				
Segment Lokal	0.70	0,021	1,50	0,83
Segment njefish	1.06	0,032	2,50	0,83
Segment dyfish	1.54	0,046	3.50	0,83
Origjinimi ne Albtelecom:				
Segment dyfish	1.54	0,046	3.50	0,83
Tranzitimi ne Albtelecom:				
Tranzit Njefish	0.36	0,011	1,5	0,83
Tranzit Dyfish	0.84	0,025	2.5	0,83

Shënim:

1. Për tarifën e origjinimit, terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve për ofruesit e shërbimeve me kartë të parapaguar, aplikohen vlerat sipas segmentit përkatës dyfish në rrjetin Albtelecom.

2. Tarifën janë pa TVSH.

- AMC sh.a mbi Vendimin nr. 1348, datë 26.07.2010 ka bërë ankimim administrative mbi vendosjen e këtyre tarifave, për të cilin AKEP vendosi rrezimin e tij;
- AMC pas rrezimit nga AKEP të ankimit administrative mbi VKD nr. 1348, i drejtohet Albtelecom për mënyrën e aplikimit të tarifave të terminimit të Albtelecom nga rrjetet Mobile.
- Për sa më sipër AMC i qëndron pretendimit se, nga ana e Albtelecom duhet të kemi një tarifim të thirrjeve të terminuara në rrjetin fiks sipas segmenteve të cilat duhet të aplikohen sipas zonave ku terminohet thirrja;
- AMC kërkon që zona e Tiranës të tarifohet me tarifa si një zonë lokale;
- AMC pretendon se argumenti i Albtelecom, që interkoneksioni realizohet në centralet tranzite të Albtelecom dhe se lidhja me centralet tranzite përcakton terminim në segment të dyfishtë, nuk është bindës dhe i saktë;
- Gjithashtu AMC sqaron se, për zonën e Tiranës ky central ndodhet brenda zonës së Tiranës dhe për këtë arsye ska pse të tarifohet për segment dyfish, dhe thekson se trafiku që terminohet në këtë zonë, pra të Tiranës të klasifikohet si trafik lokal, apo rajonet si trafik në segment lokal;
- AMC argumenton se pretendimi i Albtelecom në shkresën nr. 4002/7, datë 04.11.2010 se diferencimi në tarifa zbatohet vetëm për operatorët alternative me rrjete fikse që janë të autorizuar të operojnë në zona të caktura gjeografike për ofrimin e shërbimit të telefonisë fikse në bazë të numeracionit përkatës të miratuar nga AKEP, nuk qëndron nga pikpamja

ligjore dhe rregullatore, sepse Albtelecom thjesht shet shërbimin e terminimit në rrjetin e tij pa diferencur nëse trafiku që terminon është fiks apo mobile.

- Për sa më sipër AMC vlerëson se, Albtelecom duhet të trajtojë shërbimin e terminimit të thirrjes pa diskriminim midis operatoreve celulare dhe atyre Fiks, gjithashtu ngre pyetjet:
 - Se si është e mundur që terminimi te operatori incumbent të paguhet me shtrenjte se tek operatorët alternative?
 - Gjithashtu si shpjegohet nga Albtelecom se ky segmentim në shërbimet me rrjetat e telefonisë fikse, implementohet për operatorët alternative dhe për rrjetin e Albtelecom nuk implementohet?
2. Albtelecom pretendon se numeracioni i operatoreve Mobile i përket konceptit të numrit jo gjeografik të caktuar çka bën të detyrueshme realizimin e interkoneksionit në centrale tranzite dhe që mundësojnë terminimin e thirrjeve në të gjithë rrjetin e Albtelecom dhe anasjelltas. Njëkohësisht Albtelecom sqaron se, nuk mund të terminohet thirrje në segmente lokale dhe një fish pa kosto shtesë për Albtelecom.
- Për se më sipër AMC argumenton se, Albtelecom vet ka zgjedhur që të gjithë trafikun hyrës nga AMC ta marrë në centralin tranzit, ku shumë mirë mund të dallonte zonën e Tiranës pa e kaluar në central tranzit. AMC thekson se, argumentimi i Albtelecom nuk është bindës pasi dhe vete struktura e tarifave të miratuara nga AKEP nuk diferencon nëse pika e interkoneksionit është në central tranzit apo lokal e rajonal;
3. AMC sh.a në ankimin e tij kërkon:
- a) AKEP të ndërhyjë dhe të zgjidhë çështjen mbi diferencimin e tarifës sipas segmentit lokal, njëfish dhe dyfish, për trafikun hyrës celular të AMC që terminohet në rajone të Albtelecom sh.a sidomos duke filluar për rajonin e Tiranës, në linjë me çmimet e Albtelecom sh.a të miratuara me Vendim nr.1348, datë 26.07.2010 të AKEP, duke rikonfiguruar skemat e interkoneksionit për eliminimin e hallkave të panevojshme dhe duke ulur kostot;
 - b) Albtelecom të zbatojë Vendimin 1348, datë 26.07.2010 të Këshillit Drejtues në të cilin citohet se tarifimi do të bëhet sipas segmentit lokal, i njëfishtë apo i dyfishtë;
 - c) AKEP të veprojë në të njëjtën mënyrë për uljen e kostove të interkoneksionit për të gjithë operatorët duke zbatuar parimin e jodiskriminimit;
4. Sipërmarrësi AMC sh.a me shkresë nr.4460/6, datë 18.01.2011 në përputhje me pikën 1, neni 120 të ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve” miratuar me VKD nr. 1296, datë 11.06.2010 pas përfundimit të afateve ligjore të parashikuara, ka paraqitur ankim administrativ pranë AKEP;
5. AKEP për sa më sipër konsideron se Albtelecom sh.a, në bazë të VKD nr.1348, datë 26.07.2010 “Për përcaktimin e sipërmarresit Albtelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe

tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonise fikse” si sipërmarrës me fuqi të ndjeshme në treg ka detyrimin për akses dhe interkoneksion dhe përdorimin e përbashkët të faciliteteve të rrjetit, si dhe në zbatim të nenit 50 të Ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 zgjidhja e mosmarrëveshjes mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me iniciativën e AKEP;

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brëndshme,

V E N D O S:

1. Të fillojë procedim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis AMC sh.a dhe Albtelecom sh.a.;
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me përbërje si:
 - Altin Rrapaj Kryetar
 - Jonida Gjika Anëtar
 - Jetmir Braha Anëtar
 - Florida Çela Anëtar
 - Dede Jakaj Anëtar
3. Të njoftohen palët e interesuara AMC sh.a dhe Albtelecom sh.a për fillimin e procedimit administrativ;
4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
5. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**